



Qyteti i Helsinki-t
Byroja për Çështje Sociale

Bazat për mundësimin e ndihmës elementare sociale 2008

Ndihma elementare është e dedikuar si ndihmë e përkohshme, me të cilën sigurohet egzistenca, atëherë kur personi ose familja nuk mund t'ia del me të ardhurat nga vendi i punës, veprimtaria afariste ose me të ardhurat tjera apo me pasuritë e veta. Ndihma elementare kryesisht kërkohet me shkrim me anë të formularit së kërkesës. Para mundësimit të marrjes së ndihmës sociale duhet të sqarohen parakushtet për marrjen e beneficioneve apo të ardhurave tjera, meqenëse secili e ka për obligim të kujdeset për egzistencën e vet sipas mundësive të veta. Punëtorja për çështje sociale apo asistentja për çështje sociale iu ndihmojnë për të gjetur zgjidhje në problemet rreth sigurimit të egzistencës dhe e përkrahë klientin e papunë për t'u punësuar.

Si llogaritet shuma e ndihmës elementare?

Së pari llogaritet gjithsejt të ardhurat dhe pasuritë që kërkuesi/familja i ka në dispozicion. Nga këto të ardhura zvogëlohet shuma që është e përcaktuar për ushqim dhe për shpenzime tjera elementare (me emrin pjesa themelore) si dhe shpenzimet tjera të pranuar për kompensim. Nëse të ardhurat janë më të vogla se shpenzimet e pranuar, atëherë personi ka të drejtë në ndihmë elementare sociale.

Shuma e pjesës themelore ndryshon sipas numrit të anëtarëve përbërës të familjes dhe moshës së fëmijëve që janë nën kujdesjen e tyre.

Pjesët themelore të ndihmës elementare nga 1.1.2008

	Pjesa themelore e plotë euro/muaj	Pjesa themelore e zvogëluar	
		20 % euro/muaj	40 % euro/muaj
Personi që jeton vetëm dhe kujdestari i vetëm	399,10	319,28	239,46
Personi tjetër që ka mbushur 18 vjet	339,24	271,39	203,54
Personi që ka mbushur 18 vjet dhe jeton tek prindi	291,34	233,08	174,81
10-17 vjeçar	fëmii i 1. 279,37		
	fëmii i 2. 259,42		
	fëmii i 3. etj 239,46		
0-9 vjeçar:	fëmii i 1. 251,43		
:	fëmii i 2. 231,48		
	fëmii i 3. etj 211,52		

Pjesa themelore e ndihmës elementare përmban

Pjesa themelore mbulon shpenzimet në vijim:

- shpenzimet për ushqim
- blerjen e rrobave, larjen e tyre dhe riparimin e tyre
- pagesat tek berberi dhe floktorja
- shpenzimet rreth pastërtisë personale
- barnat e marrura nga barnatorja pa përshkrimin e mjekut dhe shpenzimet e vogla rreth pajisjeve për kurim poashtu edhe ilaçet e përshkruara nga mjeku për të cilat nuk mundësohet kompensim nga sigurimi shëndetësor
- shpenzimet e udhëtimit në brendësi të Helsinki-t
- pagesa e lehtë për TV, pagesa e porositjes së gazetës dhe shpenzimet rreth përdorimit të telefonit
- shpenzimet rreth përdorimit të internetit
- shpenzimet e vogla për rekreacion dhe hobi

Përveç pjesës themelore ndihmës elementare sociale mund të mundësohet edhe për shpenzimet tjera themelore:

- Shpenzimet e arsyeshme për banim (qiraja, uji, ngrohja, pagesa për mirëmbajtjen e ndërtesës, kamata e kreditë për banesë)
- fakturat e arsyeshme të energjisë elektike, të gazit dhe të sigurimit së shtëpisë
- pagesat e pranueshme për pacient dhe barnat me recept të marrura nga mjeku i enteve shoqërore të mjekësisë
- shpenzimet për kujdesin ditor të fëmijëve, ku kërkohet dëshmia për pagesën e bërë
- shpenzimet e patjetërsueshme rreth ndërrimit të banesës
- shpenzimet e detyrueshme për varrim ku zyra e socialit jep dokumentin për obligim financiar për firmën me të cilën ka marrëveshje
- shpenzimet e patjetërsueshme për udhëtim në vendin e punës dhe shpenzimet që shkaktohen nga vijimi në punë.

Në bazë të konsideratës mund të mundësohet ndihmë elementare sociale plotësuëse ose ndihmë për evitim poashtu edhe për shpenzimet tjera që shkaktohen nga rrethanat e veqanta. Përkrahja e veqantë mund të jetë e nevojshme nëse të ardhurat janë të ulta për një kohë të gjatë psh. për arsye të papunësisë apo sëmundjes. Poashtu mund të mirret në konsiderim që pala të përkrahët materialisht me ndihmë sociale nëse tregohet aktiv në punësimin e vet apo pjesëmarrjen e tij në ndonjë rehabilitim.

Zbritja e pjesës themelore

Nëse nevoja për ndihmë elementare shkaktohet nga ajo që personi pa shkak të argumentuar ka refuzuar vendin e punës të ofruar ose ndonjë veprimtari nga Byroja për punësim, atëherë pjesa themelore mund të zbritet më së tepërmi me 20 %. Nëse refuzimet përsëriten atëherë pjesa themelore mund të zbritet më së tepërmi me 40%. Për zbritjen e pjesës themelore vendoset që gjatë një here të zbritet më së shumti për dy muaj. Gjatë bërjes së vendimit për zbritje puntor-i, ja i, e socialit së bashku me klientin hartojnë një plan rreth asaj se si klienti mund që të përparoj në drejtim të punësimit dhe pavarësisht ta siguroj egzistencën e vet.

Si ndikojnë të ardhurat dhe pasuria në mundësimin e ndihmës elementare sociale?

Si të ardhura llogariten të gjitha të ardhurat neto dhe pasuria të cilat janë në dispozicion të kërkuesit dhe të familjes së tij ku të cilat nuk janë të nevojshme për sigurim të vazhdueshëm të egzistencës. P.sh. banesa e vet, mobiljet dhe pajisjet tjera të punës janë të domosdoshme ndërsa kursimet, dokumentat e vlerëshme si dhe automobili mund të merren parasysht si pasuri, ku pala duhet pikësisht t'i shfrytëzon ato për egzistencë. Për inkurajimin e punësimit nuk marrim parasysht të ardhurat familjare deri në 20% dhe më së shumti deri 150 euro në muaj. Të ardhurat janë paga, të ardhurat nga veprimtari afariste ose të ardhurat për mbikqyrjen e të afërmit.

Kthimi prapa i ndihmës elementare sociale

Ndihma elementare ose një pjesë e saj mund të kërkohe të kthehet nga marrësi

- nëse ndihma elementare është mundësuar parakohe ose në tërësi apo një pjesë e saj për deri sa të merret beneficioni që pritet të mirret sikurse që janë pensioni, sigurimi i papunësisë, alimentacioni, përkrahja materiale për pagimin e qirasë, përkrahja financiare për studime etj.
- nëse pranuesi i ndihmës posedon asi lloj të ardhurash, pasuri, pronë ose të drejtë për beneficion të tillë që ta siguron jetesën e i cili beneficion nuk është në dispozicion të pranuesit kur t'i mundësohet ndihma elementare.
- nëse pranuesi i ndihmës me qëllim e ka lënë pas dore obligimin për t'u kujdesuar për jetesën e vet apo të familjes.

Si kërkohe ndihma elementare?

Ndihma kërkohe prej stacionit për çështje sociale të rrethinës ku banon. Zyrja e shërbimeve sociale në gjuhën suedeze i shërben klientët që flasin gjuhën suedeze si gjuhë amtare. Zyrja e shërbimeve sociale për persona pa banesë i shërben klientët të cilët nuk kanë banesë. Ndihma elementare kërkohe me shkrim duke përdorur fletëkërkesën adekuate.

Dokumentet që duhet aneksuar kërkesës për ndihmë elementare

- dokument identifikimi (gjatë vizitave personale)
- antarët e familjes që janë në punë duhet ti sjellin dëshmitë për pagat e tyre së paku për dy muajt e fundit
- afaristët duhet sjellur sqarimin rreth veprimtarisë së ndërmarrjes afariste dhe të ardhurave të marrura nga ato
- dëshmitë rreth pensioneve dhe beneficioneve
- dëshmitë për të ardhurat tjera, psh. beneficionet prej KELA-së
- librezat bankare apo ekstratet e kontosë më së paku për dy muajt e fundit
- dëshmi për tatiminim e konfirmuar
- faktura e paguar e qirasë, kontrata rreth qirasë dhe ekstrati nga regjistri i banesës ku jeton
- të gjitha dëshmitë tjera të mundshme të cilat sqarojnë situatën ekonomike

Nëse gjatë kohës së mundësimit të ndihmës sociale situata e kërkesit të ndihmës ndryshon atëherë, klienti duhet që përnjëherë t'i lajmëroj të dhënat që kanë ndryshuar në stacionin për çështje sociale. Për shembull për ndryshimet në të ardhura, ndërrimi i banesës, për punësim, rreth fillimit të studimeve apo shtrirjes në spital mbi dy javë duhet të bëhet lajmërimi.

Dhënja e të dhënave false zyrtarëve është vepër që denohet me ligj.

Zyrtarët e zyrës për çështje sociale e kanë obligimin për mbajtjen e sekretit dhe të drejtën që të marrin të dhëna prej zyrtarëve tjerë që kanë të bëjnë me klientin. Të dhënat regjistrohen në sistemin e të dhënave të klientëve. Fletushka ku spjegohet sistemi në fjalë mund të shihet në këtë adresë: www.hel2.fi/rekisteriseloste/

Shqyrtimi i kërkesës dhe mënyrat e pagesës së ndihmës

Shqyrtimi i kërkesës me shkrim zgjat zakonisht prej një deri në dy javë(shtatë ditë pune). Shqyrtimi përshpejtohet nëse formulari është plotësuar me kujdes dhe të gjitha dokumentet e nevojshme i'u janë aneksuar kërkesës. Vendimi rreth ndihmës elementare dhe dokumentet e aneksuara i dërgohen klientit me postë. Ndihma e mundësuar paguhet në konton e

klientit. Ndihma e mundësuar për qira zakonisht paguhet drejt në konton e qiradhënësit.

Kërkesa për ndryshim të vendimit

Nëse kërkesi i ndihmës elementare është i pakënaqur rreth vendimit, atëherë mund të kërkoj ndryshim në të prej bordit për të rritur. Në vendimin e ndihmës elementare gjenden udhëzimet për të kërkuar ndryshim.

Shembull ilustrues për llogaritjen e ndihmës elementare sociale

Ndihmë sociale është duke kërkuar një familje ku babai është i papunë dhe merr si beneficion përkrahje materiale për papunësi (työmarkkinatuki) ndërsa nëna është amvise dhe merr përkrahje materiale për maternitet (äitiysraha) si dhe pagesë të vogël pune. Në familje janë dy fëmijë njëri në moshën 6 vjeqare dhe tjetri nën moshën 1 vjeqare. Familja merr edhe përkrahje materiale rreth qirasë (asumistuki) dhe shtesat e fëmijëve.

Të ardhurat	Euro
Përkrahja materiale për papunësi	538,88 në muaj
Përkrahja materiale për maternitet	330,65 në muaj
Përkrahja materiale për qira	523,40 në muaj
Shtesat e fëmijëve	210,50 në muaj
Të ardhurat gjithsejt	1603,43 në muaj

Shpenzimet, pjesa themelore

Babai	339,24 në muaj
Nëna	339,24 në muaj
Fëmiju i parë	251,43 në muaj
Fëmiju i dytë	231,48 në muaj
Qiraja (faktura)	680,00 në muaj
Pagesa e ujit (faktura)	40,00 në muaj
Faktura e telefonit	90,00 nuk pranohet, hyn në pjesën themelore
Pagesa e TV:së	47,50 nuk pranohet, hyn në pjesën themelore
Blerja e rrobave	45,00 nuk pranohet, hyn në pjesën themelore
Blerja e biletës	41,60 nuk pranohet, hyn në pjesën themelore

Shpenzimet gjithsejtë 2105,49 në muaj

Shpenzimet e marrura parasysht gjithsejt

1881,39 në muaj

Të ardhurat gjithsejt

-1603,43 në muaj

Ndihma elementare sociale

277,96 në muaj

Vendimi për ndihmën elementare sociale

Mundësohet ndihmë elementare për një muaj 277,96 euro. Përveç kësaj mundësohet gjatë kohës kur vendimi është në fuqi të paguhen faturat e arsyeshme të rrymës si dhe pjesa vetëpërgjegjësisë për pagesën si pacient në ente shoqërore të mjekësisë dhe barnat për shërim të sëmundjes të përshkruara nga mjeku.